



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

**nga procesverbali i mbledhjes së 23-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit
 mbajtur, më 30.10.2023, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰**

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Majlinda Sylejmani, anëtare
14. Gentianë Hoxhaj, anëtare
15. Venhar Agushi, anëtar
16. Xhyla Dedushaj, anëtare
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar
28. Shahadije Dragaçina, anëtare
29. Besiana Sylja, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Valon Pacolli, DEZH
5. Shkelzen Hajdini, DSH
6. Elmaze Behluli, DA
7. Sead Aliu, DI
8. Rexhep Rexhepi, DBP
9. Rasim Hasani, DA
10. Safete Amerrlahu, DGJK
11. Burim Rrustemi, DSHPMSH
12. Imri Semetishti, DUPMM
13. Anila Reqica-LLugiqi
14. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit ,pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 22-të e Kuvendit.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Shtator 2023.
3. Propozim Vendim për miratimin e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Lipjanit 2023-2027.
4. Propozim Vendim për Fillimin e proceduarave për shpalljen e konkursit publik për vendosje të bizneseve në zonën ekonomike “Parku Industrial” në ZK Qylagë – faza e dytë.
5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike “Parku Industrial” në ZK Qylagë – faza e dytë.
6. Propozim Vendim mbi caktimin e tarifave për qëndrim ditor të fëmijëve në institucionet parashkollore në fshatrat e Komunës së Lipjanit.

7. Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës për përzgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Lipjanit.
8. Propozim Vendim për faljen e borxheve të pa paguara për taksën për marrjen dhe mbajtjen e lejes për ushtrimin e veprimtarive afariste.
9. Propozim Vendim për anulimin e Vendimit 15Nr.463-4331 i datës 19.01.2021 për pezullimin e Vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varreza në fshatin Rubovc 15Nr.463-14826 i datës 04.03.2019.
10. Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Komunitete.
11. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për OJQ “Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve”.
12. Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtares të Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në Zk. Konjuh.

Me të gjitha votat për 29 u aprovua rendi ditës. .

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Albiona Tasholli, tha se para disa dite kam pranuar disa kërkesa nga disa qytetarë prej lokacioneve të ndryshme, si Gatime, Janjevë, Vrellë të Gadimes për rregullimin e ujërave të zeza , të cilat janë të nevojshme për plotësimin e kushteve për qarkullim të lirë. Përveç kësaj, kam pranuar edhe një kërkesë tjetër të banorëve të Mirenës, për rregullimin e kanalizimit, si dhe për rregullimin e disa rrugicave po ashtu në këtë fshat. Kam një pyetje për kryetarin apo drejtorin e arsimit: a e keni paraparë ndërtimin e një shkolle fillore në qytetin e Lipjanit në vitin e ardhshëm dhe në cilin lokacion, sepse konsideroj se qyteti ka nevojë edhe për një shkollë tjetër të re.

Arsim Jashari, tha se pari, është mirë që zërimi u rregullua, se po ka problem zërmi nëse shikojmë në YouTube, nuk kuptohet gati shumica e fjalëve. Kish qenë mirë me fol me operatorë teknikë ata që e kanë bo se me të vërtetë nuk është në rregull. Komuna e Shtimes, e ka të rregulluar shumë mirë. Unë sot kam për t'i parashtruar për ju disa kërkesa të banorëve dhe disa pyetje për ekzekutimin në këtë rast në drejtoritë përkatëse. Kërkesa e parë vjen nga nxënësit dhe prindërit e nxënësve të fshatit Banullë. Këta kërkojnë të vendosen pengesat në rrugë pasi që po vozisin shpejtë.

Kërkesa e dytë është i njëjti problem, ndërmarrë ndjen nga lagje e Retkoceri në hyrje të Lugaxhisë, ndërmjet fshatit LLugaxhi dhe Bujari. Kërkesa e tjetër është nxënësve të cilët po ankohen për papastërtie nëpër WC dhe nëpër shkolla. Kërkesa tjetër vjen nga këshilli i fshatit Banullë, të cilët kërkojnë asfaltimin e rrugës “Lama” mungon edhe trotuari në ndriçimi. Pyetje për drejtorin e Bujqësisë: A kemi planifikuar apo menduar t'i vëmë një analizë tokës pjellore për të parë se cilat rendimente mund të jenë më fitimprurëse? Tjetra ,kryesues, tash e dy vjet e kemi bërë planin e punës së Kuvendit, ende asnjë aktivitet s'e kemi bërë si Kuvend, si anëtarë të Kuvendit, as kemi vizitua asnjë Kuvend tjetër, asnjë parlament, asnjë institucion, është mirë me marrë një iniciative dhe me vizituar ndonjë institucion.

Ganimete Qeriqi, tha se kam vu re subvencionet që ka ndarë komuna , për bujqit ,klubet sportive e të tjera. Ka edhe kategori të tjera që duhet të subvencionohen, duhet të ndihmohen familjet që kanë anëtarë të sëmurë , me sëmundje të zgjatur shumë kohë ,me 10 deri 15 vite, me paralizë e demence. Realisht këtë kategori në mbikëqyrje duhet ta merr institucioni (shteti) Komuna akoma si ka këto institucione as s'ka kapacitete prej marrë nën kujdes këta të sëmurë dhe barra e rënda po ju mbetet familjeve. Ama këto familje duhet me u ndihmuar .Këto familje duke u kujdesur për këta të shënuar kanë shpenzime të mëdha gjithashtu gratë po e pësojnë shumë .Nuk kanë mundësi të punojnë as të shkollohen dhe janë të izoluar 24 orë në shtëpi Këto familje duhet ndihmuar me mjete higjienikë ,sanitare, barna ,ushqime etj ,pse jo edhe një pagë simbolike për gruan që kujdeset 24 orë për të sëmurin.

Ardit Cani, tha se kam disa kërkesa e para është për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për vendosjen e shenjave informuese për vizitorët që vijnë tek burimi i nxehtë në Bainsë Kërkesë tjetër kanë drejtuar Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorisë për Arsim për ndërtimin e një sallë sportive në shkollën e Bainsës, sallë të brendshme, pasi që ka nevojë të madhe , sepse nxënësit do të kishin mundësi më të zhvillojnë aktivitetet e tyre gjatë kohës së dimrit. Një pyetje e kam për Drejtorinë e Infrastrukturës, se kur do të fillojnë asfaltimet e rrugicave për këtë vit?

Lulzim Rustemi, I kam nja tri kërkesa dhe një nja tri pyetje dhe një kërkesë. E para, meqenëse ka filluar punimet e Parkut Qendror Nëntokësor në Lipjan, kisha pyet kryetarin për koston e shpronësimeve ,A ka kosto të shpronësimeve? A janë kryer të gjitha shpronësimet? E dyta çka po ndodh në Shtëpinë e Kulturës në Lipjan, në projektin e ri? E treta, pyetje për shtigje të ecjeve në Gadime. A kanë përfundua dhe në cilën pozicion dhe a është kompletuar komplet projekti i shtigjeve të ecjeve në Gadime, te pishat? E katërta, kam një kërkesë për pjesën që e përcjell, në IT-ja që i përcjell xhirimet e asamblesë. Ne po kemi në kamerë vështirësi me dalë. I kemi

mikrofonat, por besoj që fokusimi i kamerave nuk është i mirë. Paraqitja zakonisht fotografia që dalim edhe kur flasim tash, por edhe kur flasim prej vendit nuk është e mirë. Nuk e di a kanë mundësi teknike për me rregulluar pak më mirë. E kemi parë Komuna e Shtimes, fokusohet, e secili individ kur diskuton, fokusohet derisa të diskuton ai edhe tërhiqet, nëse është e mundur teknikisht me rregullua kjo çështje, do të ishte shumë ma e mirë.

Herolind Kozhani, tha se unë kam dy kërkesa. Desha të ju pyes se ku ka mbetë çështja e ujit të pijshëm për fshatrat Ribar i Madh - Kraishtë - Bujan, ku dihet se janë zhvillu punimet në atë pjesë. Ndërsa tani që disa kohë nuk ka asnjë lëvizje në atë drejtim, si dhe çështja tjetër është çështja rrugëve për mirëmbajtjen në sezonën dimërore, a janë bërë të gjitha parapërgatitjet e nevojshme.

Shahadije Dragaçina, Kërkesa ime e parë është nga banorët e fshatit Bujan. Rruga është asfaltuar Kraishtë Bujan dhe ata kërkojnë që në bazë të mundësive të ketë edhe policë të shtrirë, për shkak se ajo rrugë që i lidh dy fshatrave të Kraishtën me Bujan po ka vozitje të shpejtë të veturave. Ndërkohë, disa banorëve të rrugës së Gajtani në Jnajevë thonë që është punuar në kanalizim, ndërkohë që sipas tyre është lënë në gjysmë. Dua të dijë Drejtoria e Shërbimit Publike pse nuk ka përfunduar ai kanalizim.

Alban Salihu, tha së pari dëshiroj që nga këto t'i uroj shërim të shpejtë të gjitha grave që janë duke u përballur me sëmundje të rëndë të kancerit të gjirit. Gjithashtu, nga këto i ftoj gratë tjera që të bëjnë ekzaminime dhe uroj që numri i të prekurave nga kjo sëmundje e rëndë të shkojë duke u zvogëluar. Jemi dëshmitarë, që në muajin e fundit, është bërë virale çështja e stadiumit të Dobrajës. Është thënë që nga zyrtarët e komunës që stadiumi është dorëzuar te klubi dhe klubi është përgjegjës për mirëmbajtjen e tij. Pyetjet e mia janë këto: Në çfarë date është dorëzuar stadiumi te klubi? Kur është bërë prerja e shiritit, pra kur është përfunduar ky projekt, a ka ndonjë postim ose ndonjë fotografi?

Bashkim Budakova, tha se kam një pyetje për ekzekutivin, nëse kemi një analizë të kësaj natyre ose në bashkëpunim me Kompaninë Rajonale Ujësjellësi Prishtina, cila është cilësia e ujit të pijes në nivel komune? A kemi një analizë fiziko-kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijes, ku dihet se një numër i madh i fshatrave nuk furnizohen me ujësjellës, madje edhe një numri i madh i shkollave nuk e kanë rregulluar çështjen e ujit të pijes. Pra, cila është cilësia e ujit të pijes në nivel komune?

Besiana Sylja, tha se unë e kam një çështje për me ngritë edhe një pyetje për kryetarin e komunës. Një çështje që dua të ngris ka të bëjë me një qendër inovative.

Një qendër e inovacionit i mungon komunës së Lipjanit. Brenda një qendre të tillë munden me u mbajë trajnime nga më të ndryshme, e ku të rinjtë nga komuna e Lipjanit munden me u përgatitë edhe me qenë të gatshëm për tregun e punës. Në disa sektorë që lidhen me tregun e punës e veçmas një kompani ku ka të bëjë me veprimtari teknologjike. Besoj që shumë kompani vendore të programimit mund të marrë dhe me i trajnua falas të rinjtë brenda një intervali kohor duke iu dhënë parapërgatitje apo duke i profilizuar për tregun e punës. Po flas për një qendër multifunksionale me shumë shërbime teknologjike. Një pyetje për kryetarin e komunës që desha një shpjegim më detajushëm për thirrje për projekte të vogla për rininë e të rinjve Lipjanasë.

Egzona Bytyqi, tha se atëherë, edhe këtë seancë nuk kam se si mos me filluar me muajin tetor. Sinqerisht e nga zemra i falënderoj të gjithë ata, qoftë profesionistë, mirëpo kushdo që ka jep kontribut në këtë muaj, sepse e vlerësoj si shumë të rëndësishëm lidhur me natyrën e sëmundjes që tashmë gjithë ju pak a shumë jeni të njoftum. Atëherë, edhe muajit tetor, muaj më thanë si asnjëherë më parë edhe në Komunën e Lipjanit u shënua me disa aktivitete, çka që jam për mu vlerësua? Sa i përket ligjëratave, i kam vërejtjet e mia, sepse fokus ju jep, ju është jep personeli shëndetësor edhe kërkesë e imja në këtë rast ka qenë që të trajtohen grupet e marginalizime, në veçanti, mirëpo në përgjithësi edhe lokalitetet e mëdha me qytetarë, domethënë të thjeshtë, sepse ata kanë nevojë. Tjetra, ne e kemi pasë që mamografi mobil tri ditë ka qëndrua në komunën tonë dhe drejtori, në këtë rast, mundet me ndihmua në bazë të informacioneve që i kam diku katërqind kërkesa, domethënë kanë qenë prej grave që kanë pasur dëshirë me realizua këtë teknikë diagnostikuese. Domethënë, duke e krahasua këtë numër kaq të madh, mirëpo edhe marrëveshjen, nëse s'gaboje drejtor, që e kemi për muajin nëntor, unë e kisha kërkuar dhe e kisha lut edhe Drejtorinë e Shëndetësisë, mirëpo edhe ekzekutivin që përmes çdo vit na po kemi rritje të hyrave vetanake, me gjetë mundësi financiare ose përmes ndonjë granti, sepse është shumë i rëndësishëm këtë aparaturë diagnostike komuna jonë me e pasë çdo herë, jo vetëm muajin tetor dhe uroj që aktivitetet, tilla të shtrihen edhe gjatë muajve në vazhdim, jo vetëm tani. Çështja tjetër ka të bëjë gjithashtu me Drejtoratin e Shëndetësisë, meqenëse Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, së bashku me Ministrinë, tashmë ka jep informacion sa i përket asaj që tri vaksina të reja janë futë në kalendar të rregullt të vaksinimit. Për rëndësinë preventive të sëmundjeve infektive nuk kam çka flas sot këtu, sepse dihet, mirëpo ajo çka dua ta pyes drejtorin nëse ka informacion, më intereson shumë me ditë. Si është dispononi ose sa është gatishmëria e prindërve që me i vaksinua fëmijët, sidomos kundër himon-papilloma virusit, që është shumë i rëndësishëm Ne në kuadër të vizitave sistematike që janë obligativ

ligjor, domethënë që realizohen tek nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, unë kam kontaktua me disa shkolla dhe domethënë ato si rutinë nuk po ndodheshin. Më intereson me ditë si e kemi gjendjen në shkolla sa i përket kompletimit me libra, pasi që u ka një problematikë në vete tejet specifike. Çështja tjetër domethënë ka të bëjë me asfaltimin e rrugicave që po ndodhin në fshatin tim Qylagë Unë për hir të korrektësisë është dashtë me ngritë në Kuvend, pasi që në përpilim të buxhetit nuk specifikohen rrugët edhe rrugica me emra, kështu që nuk kam pasë informacion nëse ajo rrugë ka më shtrua ose jo. Edhe për fund, ne në mandatin e kalum e kemi pasë një marrëveshje lidhur me binjakëzimin me dy komuna italiane, nëse nuk gabo. Dua të di nëse ai është ende valide dhe dua të di nëse kemi pasë ndonjë përfitim me këtë binjakëzim, të ashtuquajtur, në cilëndo sferë.

Rinor Murati, tha se sa i përket adresimit të çështjeve, konsideroj çështje urgjente konsumimin e duhanit nga nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulët. Ligji për kontrollin e duhanit, përkatësisht neni dhjetë parandalimi i qasjes së të miturve në produktet e duhanit, përcakton që asnjë person nuk ka të drejtë t'u shesë të miturve produktet e duhanit dhe se dyqanet detyrohen të shesin në vendet e tyre të shitjes të vendosin në vendet e tyre të shitjes shenjat për ndalimin e shitjes së produkteve personave të mitur. Me këtë rast, apeloj stacionin policor, përkatësisht komandantin e policisë, të cilit edhe ia kanë parashtruar këtë kërkesë, drejtorinë e inspektoriatit, drejtorinë e arsimit dhe drejtoritë e shkollave që t'i shtojnë kontrollet karshi nxënësve lidhur me këtë dukuri. Një kërkesë tjetër nga banorët e fshatit Llugaxhitë, të cilët kërkojnë rregullimin e ngrohjes qendrore në sallën e sportit, gjë që në mungesë asaj ua pamundëson zhvillimin e aktiviteteve në sezonin e dimrit dhe një pyetje kur do të përfundojë rregullimi i urës dhe përfundimi i rrugës që lidh qytetin me fshatin e rrugës?

Fitim Mëziu, tha se jemi në përfundim të ndërgjegjësimit të qytetarëve, të pacientëve nga sëmundjet , por edhe jo të sëmurë, nga kanceri i gjirit. Kjo duhet falënderuar të gjithë! Institucionet, anembanë Kosovën, por edhe në Lipjan, për kontributin të cilin e kanë dhënë në mënyrë që masat preventive të jenë më adekuate, në mënyrë që të kemi sa më pak pacientë me probleme të tilla shëndetësore. Uroj që në të ardhmen të kemi sa më pak pacientë me probleme të tilla shëndetësore. Komuna e Lipjanit ka shumë nevojë të ketë një mamograf, në mënyrë që shërbimet shëndetësore qytetarët e komunistë tanë t'i marrin në qendrën kryesore të mjekësisë familjare. Gjithashtu, për Drejtoratin e Shëndetësisë kam edhe disa kërkesa që grupet të cilat merren me edukimin shëndetësor, qoftë edhe me ngritjen e ndërgjegjësimit për sëmundje të ndryshme, të jenë nga qendra kryesore e mjedisë familjare të jenë të

ndryshme dhe mos të jenë i njëjti grup për të gjitha problematikat shëndetësore. Ne e dimë, domethënë se në tërë botën, kohët e ne, sëmundjet kardiovaskulare po ashtu kanë një rritje të madhe, ballafaqimi me infartin e miokardit, me pikën në zemër, siç thonë populli. Pra, kërkesa ime është që brenda Institucionit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare të formohen disa grupe, të cilat në rast të shënimit të ditëve të ndryshme ndërkombëtare që janë të gatshme menjëherë të dhojnë kontribut, pra jo të njëjtit njerëz, edhe pse problematika shëndetësore duhet në vazhdimësi të përcillet Kjo është edhe detyrë e mjekut, sidomos specialistit të mjekësisë familjare, e cila pra e ka për detyrë që pacientët e vet të cilët i ka në listë, t'i kontrollojë, t'i edukojë, pra por pyetja e parë që duhet, faktikisht aktivitetin e parë që duhet të ngrenë ata është realisht do të thotë parandalimi që është kusht themelor për edhe për parandalimin e sëmundjeve, por edhe në këtë rast ndikoni edhe në koston financiare, si të komunës po ashtu edhe familjare në përgjithësi.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se unë kam një çështje në lidhje për parkun e qytetit të Golden Dey, si quajmë ne i cili lë shumë për dëshiruar sa i përket mirëmbajtjes, por më tepër aty është një shatërvan i cili përveçse nuk është funksional, ai ka filluar edhe të shkatërrohet nga qytet qytetarët e pandërgjegjshëm. Prandaj, unë kërkoj nga komuna që krahas investimeve të reja për parqet e reja që të intervenojë dhe të mirëmbajë edhe parqet e vjetra, park i cili është ndërtuar jo shumë moti, por që sot fatkeqësisht të krijon përshtypjen e një parku të braktisur e të harruar kaheerë.

Fadil Spahiu, tha se kam disa kërkesa e parë është për Drejtoratin për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim nga familjet Krasniqi dhe Thaçi të fshatit Smallushë. Banorët e kësaj lagje, përkatësisht familjet Krasniqi dhe Thaçi, që gjenden në rrugën dy prilli, kanë bërë kërkesë që të bëhet lidhja në rrjetin e kanalizimit të fshatit sepse për arsye të pozitës gjeografike të oborreve të tyre, ku gjenden shtëpitë, kyçja në rrjet ka qenë e vështirë në kohën kur është bërë shtrirja Por disa ditë më parë kanë arritur pëlqim nga pronarët e parcelave, nëpër të cilat kyçja në rrjetin do të bëhet shumë e lehtë. Këto familje kanë kërkuar që kërkesat e tyre, në bazë të mundësive, të shqyrtohet me urgjencë, sepse moskyqja në rrjet po u shkakton dëme këtyre familjeve, si dhe familjeve të tjera që banojnë aty pranë tyre, nga të cilat edhe kanë marrur vërejtjet e fundit dhe pothuajse janë pranë një konflikte të mundshëm. Kërkesë për Drejtoratin e Infrastrukturës. Banorët e një lagje, që lidhen me rrugën njëmbëdhjetë qershori, në fshatin Smallushë, kanë bërë kërkesë që në kuadër të projektit të asfaltimit të rrugicave, të asfaltohet rrugica e lagjes së tyre Këtë rrugicë e shfrytëzojnë familjet Mehmet, Shaban, Bujar dhe Besnik Hajdari. Kërkesa e tretë është përsëri për Drejtoratin e Infrastrukturës, nga banorët e lagjes, që lidhen me rrugën njëmbëdhjetë

qershori, kanë bërë kërkesë që në kuadër të projektit të asfaltimit të rrugisave të asfaltohet rruga e cila e shfrytëzojnë familjet Ramush, Afrim, Naim dhe Afrim Krasniqi Hapësirat e rrugëve që përshkojnë këto parcelat aktualisht janë prona private, por ushtruesit e kërkesave kanë shprehë gatishmëri për marrëveshje për asfaltimin e tyre apo edhe t'i kalojnë në prona publike nëse është e nevojshme. Kërkesa e katërt është për drejtoratin për shërbime publike mbrojtje dhe shpëtim nga banorët e fshatit Vrellë të Gadimës. Familja Beslim-Krasniqi ka bërë kërkesë që të kyçet në rrjetin e ujësjellësit, sepse në kohën kur është bërë shtrirja e ujësjellësit në atë fshat, kjo familje nëpër një periudhë nuk ka qëndruar nuk ka qenë duke banuar aty dhe rrjedhimisht nuk është bërë kyçja në rrjetin e ujësjellësit, mirëpo tash e një kohë janë kthyer me banim të përhershëm të banojnë aty dhe meqë nuk janë të kyçur në rrjetin e ujësjellësit, banimi në atë shtëpi është bërë vështirë para familjeve. Edhe një pyetje e kam për anëtarët e Komisionit për rishqyrtim, emërim dhe emërtim të rrugëve. Deri në cilën fazë ka arritur takimi me qytet m'i ngritë edhe kërkesat apo me i interpretua në mënyrë të duhur nga qytetarët pa emrat e rrugëve, e po duhet m'i përmendë emrat e kryefamiljarëve, të cilët i përshkojnë ato rrugica dhe a ka përfundua procesi i emirëve?

Gentianë Hoxhaj, tha se kam një pyetje rreth rrugës që lidh magjistralen që lidh qytetin e Shtimes dhe Lipjanit se kur do të përfundojnë punimet, sepse ka mjaft kohë e gjatë që kanë filluar. A është në njohori komuna për këto punime se kur do të përfundojnë, sepse në të vërtetë është bërë shumë e vështirë dhe shumë e pakalueshme.

Nexhmedin Lekiqi, tha se disa ditë më parë i kemi bërë Komiteti për Shëndetësi dhe Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale, një raport. Kisha pasur dëshirë që, nëse nuk është gati drejtori për këtë mbledhje, së paku për tjetrën, mbase atyre gjetjeve dhe propozimeve që i kemi dhënë, kemi pasur që e kemi pasur një përgjigje, se këtu a ka mund diçka prej atyre kërkesave E dyta, i bashkëngjitim kërkesës së koleges Albionë rrjedh në një shkollë, në qytet, sepse jemi në kohën e fundit kur duhet të llogarisim më se të nevojshme një shkollë edhe të fillojmë përgatitjet sa më serioze për t'i plotësuar nevojat e qytetarëve për shkollë.

Imri Ahmti, kryetar i komunës tha se, si rrallëherë ka pasur kësaj radhe interesime për çështje që vërtet janë në interes të qytetarëve dhe vlerësoj shumë dhe kërkesat tua në fakt që janë nga ana e kornizave ligjore të komunës, ose të asaj që ne e administrojmë. Por, fillimisht më lejoni dy falënderime të veçanta i kam e para për Betimin dhe Liridonin, që sot janë këtu. Që, vullnetarisht, dojnë me bë transkriptin e procesverbalit tonë në formë shkrume dhe falënderojmë shumë për këtë çështje.

faleminderit shumë prej tyre! Uroj që të hyjë në agjendë tutje që vërtet procesverbali ta kenë gjithmonë në formën e tillë. E dyta dua me falënderoj gjithë stafin mjekësor, dhe asamblastit që janë të këtij profili, drejtorin tonë të shëndetësisë, me gjithë stafin, gjithë ata që ka vënë një kontrollim të jashtëzakonshëm për sensibilizimin e shoqërisë tonë për luftimin e kancerit të gjirit, sepse është një prej rreziqeve shëndetësore në nivel vendi, prandaj, faleminderit të gjithë, veç e veç për këtë angazhim dhe këtë kontribut. Ishin disa pyetje pengesat e rrugëve. E para, pranë çdo shkolle, pranë çdo institucioni shëndetësor nëpër lokalitet tona, duhet t'i vendosim pengesat dhe duhet ta kemi një agjendë që pranë çdo shkolle ku ka frekuentim të nxënësve, duhet të ketë, pengesa në rrugë, sepse janë të nevojshme. E dyta, në rrugë pa krye, siç i themi ne, ose rrugë pa dalje të lagjeve të caktuara, pengesa të tilla nuk mund të ketë dhe u kisha lutë mos bini kërkesat e qytetarëve, sepse këto nganjëherë kanë edhe konflikte edhe krijojnë situata jo të lehta në terren. Për Mirenë ka nevojë për kanalizim një pjesë, sepse nuk e ka kanalizim dhe aktualisht është duke u ndërtuar projekti detal për të parë koston sa u kushton për të futë në buxhet tutje. Është e vërtetë që Lipjani ka nevojë për shkollë, na të gjithë e dimë dhe unë mendoj që një assemble do vendos se nuk ka problem që s'mund të gjejmë mjete financiare në pranverë për të nisë një shkollë. Problemin e kemi ku me e nisë, sepse ju e dini që në shkollën "Ismail Luma" që është sot kemi mungesë në nxënësve. Do ti bijmë tri propozime nga Departamenti i Planifikimit dhe Urbanizimit, bashkë me Drejtorinë e Arsimit, për të marrë një vendim të përbashkët, i cili do të ishte lokacioni më i përshtatshëm për të ndërtuar një shkollë të re në Lipjan. Te zgjerimet e rrugëve, unë e di që ka pengesë, në rast se vërtet ka pronë komuna, unë besoj që mund të gjenim mjete për të atyre rrugëve. Tek analiza e për të tok nuk e di a është ndonjë institut që merret me këtë punë, për një fakt të di, kategorinë e bonitetit të tokave nuk mundet komuna me ndërruar. Secila e sheh se cilën kategori ose klasë është toka dhe atë s'mund ta ndërrojmë as komuna dhe as departamenti. Shenjat e trafikut, po, kemi vendos mjaft shumë. mund të vendosim. A jemi të zotë me i ru ato shenja, do të qëndrojnë gjatë nuk e di, por mund t'i vendosim. Asfaltimi i rrugicave, ne kemi në premtuar në ndërtimit të rrugicave të secilës familje. Po, Bainca është e kontraktuar rruga, Ndërsa ne Qylagë dhe disa fshatra të tjera janë në projekt. Ajo që e kam deklaruar, vazhdoj ta mbajë, unë synoj të gjitha familjeve me ia quar asfaltin te dera. Na ka mbet rruga Llugaxhi Babush, po ashtu rruga të Topliqan - Kojskës, e cila ka një kosto të jashtëzakonshme, e cila vazhdimisht e kërkon buxhet qeveritar, por s'kemi fundet, për momentin për ato rrugë. E para, kosto shpronësimit mbrapa komunës ka kushtua fiks pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë e dy pikë njëzet. Shtëpia e Kulturës e kemi pas lëndë nënë dy herë ka pasë një ankimim dhe jemi kanë në fazën e ndërtimit të projektit detal, jo në fazën e ndërtimit të shtëpisë së kulturës, po projektit detal, sepse përmes konkursit komuna ka përzgjedh një projekt ideor që ka qenë më i akceptueshëm për komunën

dhe për vendin që e kemi atje dhe ndërkohë operatori tjetër është ankuar dy herë dhe herën e dytë tash së fundit s'i ka duket as shtatëdhjetë ditë. Do të thotë, këtë vit e kemi të humbur të Shpinë e Kulturës, fatkeqësisht, për shkak të zhagjitjeve të jashtëzakonshme që na bënë me OSHP-së. Projekti i shtigjeve të gatimeve është në procedurë akoma. Projekti i shtigjeve të Gadimes është në procedurë akoma, por është penalizuar operatori dhe besoj që do një shkëputje e sipër të kontratës jemi lëtë, për shkak të dokumentacionit, mendoj që do ta shkëputmi këtë kontratë për shkak të papërgjegjësisë së operatorit dhe këtu e kemi futë në penallti. Për ujësjellësin në zonën e Kraishtës unë kam pasur takim me përzgjedhësit e CDI-së dhe me zëvendësin ambasadorin Zvicran këtë çështje. Kam kërkuar prej ujësjellësit të Prishtina për të marrë të dërguar ku ka mbetë ky proces, dhe cila është kostoja financiare për të marrë ma përsipër. Ajo që duhet nene bo, në pranverë ajo duhet me marrë përsipër këtë punë dhe me kërkuar prej CDI-së, me heqë dorë prej këtij projekti, sepse me donatorë nuk është fort e shpejtë edhe e lehtë vendimmarrja e jonë. Ë për mirëmbajtjen dimërore, besoj që këtë vit jemi jashtëzakonisht në kohë mirë. Janë lidhë të gjitha kontratat, me përjashtim në një kontrate, sepse është në publikim. Nuk e kemi zgjedhë vetëm një operator, por pesë operatorë. Uji është i pijshëm, dhe nuk kemi këtu telashe. Binjakëzim, po ka një Binjakëzim me dy komuna abreshe italiane, për të cilat janë komunat e vogla. Personalisht kam qenë atje. në këto raste nuk ka përfitime direkt, natyre po jemi shkëmbime kulturore shkëmbime kulturore, edhe ideja ka qenë me ba kontakte komunikim me disa komuna që kanë një prejardhje arbëreshë ose diçka që përfiton komuna jonë prej prej këtij komuniteti atje. Rruga Lipjan - Rruga është rrugë e ndërprerë është rrugë e financuar nga qeveria, përkatësisht Ministria e Infrastrukturës për çështje të inflacionit, tepër ka pasë impakt në këtë rrugë. Në përmes menaxherve tonë e kemi ndërprerë atë rrugë, e kemi ndërprerë atë kontratë dhe tani mjetet na mungojnë nga Ministria. I kemi vetëm njëqind e pesëdhjetë mijë euro, njëqind e pesëdhjetë mijë euro nuk po del as për urën. Shitja e duhanit po ka pasë inspektime, realisht në raportin e punës të Inspektoratit ka pasë inspektime kohë pas kohe, nuk është një fenomen i jashtëzakonshëm në Lipjan Për këtë çështje duhet një vetëdijesim tërësisht i shoqërisë, i prindërve ma së pari. Salla sportive po kërkon një kallda atje në Llugaxhi, besoj që do të kryhet shpejt, nuk o diçka që s'mund të bëhet. Problemin e kemi më tepër të punëtorëve teknikë, sepse automatikisht tërheq me vete edhe një punëtor shtesë dhe numri i punëtorëve në arsim është i limituar. Rruga Lipjan Shtime, është rruga që menaxhohet nga Ministria. Kanalizimi në Janjevë është projekt dyvjeçar, jemi në bashkëfinancim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, me Ministrinë ky është projekt dyvjeçar.

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 22-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 22 e Kuvendit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 25 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 22-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Shtator 2023.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Raporti.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se meqenëse e kemi raportin nën mujor të shpenzimeve dhe jemi përafërsisht gati në fund të vitit, kanë mbet shumë pak kohë për realizimin e buxhetit dhe fatkeqësisht mund me konstatuar që jemi larg shpenzimit të duhur të buxhetit e sidomos në investime kapitale. Nga buxheti i përgjithshëm, te buxheti dhe shpenzimet sipas fondeve burimore Granti qeveritar është shpenzuar pak buxheti. Tetë hyrat vetanake nga dy milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë janë shpenzuar shtatëqind e njëzet e dy mijë, kanë mbetur një milion e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë ose tridhjetë pikë nëntëdhjetë e tetë. Tetë hyrat vetanake të bartura një shfrytëzim shumë simbolik, tepër i vogël. Te donacionet, prapë i vogël. Si total prapë shifër e vogël. Por nëse marrim te investimet kapitale të përgjithshme, është një shifër shumë simbolike, tepër e vogël dhe kjo duhet me alarmuar ekzekutivin, duhet me alarmuar edhe qytetarët e Lipjanit. Te buxheti dhe shpenzimet nga granti qeveritar, që është tepër i rëndësishëm se mjetet të cilat nuk kthehen nëse shfrytëzohemi në periudhën e paraparë. Subvencionit dhe transferet shpenzimi i buxhetit është shpenzime e vogël Buxhetet dhe shpenzimet nga të hyrat vetanake të bartura kemi shpenzim jo te mirë. Te subvencionet kemi një shifër tepër e vogël. Buxheti edhe i shpenzimit nga donatorët e keni një shifër të konsoliduar. Unë jam nal te Granti qeveritar prej dy vite

janë pa shumë. Te shërbimet rezidenciale kemi gjithmonë një kod edhe ato janë hala zero-zero, dhe këto mund të humbin si mjete. Te arsimi para fillor, granti qeveritar te investimet kapitale keq. Ndërtimi i nënkalimit dhe vazhdimi i sheshit të hyrat vetanake e shpenzimi është ende zero Ndërtimi i qendrës urgjente në Lipjan është edhe këtu keq që do të thotë nëntë projekte i kanë shpenzimet ende zero Te ekzekutimi i pagave nga Thesari, rikonstruktimi i rrugës Ribar i Madh, rruga Vebei-Kozhani, dhe Beqir Duriqi, infrastruktura rrugore. Një sqarim shtesë A s'kemi mundësi marrëveshje. Unë besoj që ky buxhet ka me i kushtuar Lipjanit me suficit.

Besiana Sylja, tha se raporti i shpenzimit të buxhetit në bazë të burimeve dhe mjeteve dhe kategorive ekonomike janar shtator vitit 2023 Nuk kemi të bëjmë me buxhet alokuar nuk kemi të bëjmë me buxhet të miratuar. Siç përshpejtohet nga raporti, shpenzimet nuk janë në nivelin e periodës, sepse keni shpenzime mjaft të vogël ku e dimë se kanë kaluar nëntë muaj të këtij viti. Kemi projekte që nuk është shpenzuar as edhe një cent. Në pozicionin e kategorisë paga dhe mëditje nuk do të ketë mjete të mjaftueshme për pagesa e pagave, por sigurisht thesari do t'i marrë nga kategoritë tjera, nuk e di a e ka menduar ekzekutivi këtë çështje? Në bazë të raportit të ekzekutimit që i ka kryer thesari, shihet se Komuna e Lipjanit ka hyrë në obligim pa zotim të mjeteve, në projektimin dhe ndërtimin e trotuareve, rrugën Gadime Gjilan Të gjitha ekzekutimet që kryhen nga Thusari, në përjashtim të pagesave, paraqesin një gjendje jo të mirë për Komunën e Lipjanit. Në bazë të raportit të Zyrës Kombëtare të Auditorit, komuna për taksa në llogarinë e argëtueshme ka borxhe të vjetruara, A ju keni dërguar ndonjë vërejtje apo ndonjë kursim për pagesat e tyre?

Alban Salihu, tha se një buxhet i rëndësishëm për qytetarët, pjesa kryesore e buxhetit janë investimet kapitale. Domethënë, këto kode tjera buxhetore, shpenzimet, paga e mëditje, i prekin një kategori të caktuar të qytetarëve, por investimet kapitale supozohen që me prek shumicën e qytetarëve në vendbanimet e tyre. Nëse i marrim investimet kapitale, konsideroj që shpenzimi është mjaft i ulët, e çka nxitim mund me dalë me reaguar këtu. Edhe vitin e kaluar i kemi pasë shpenzimet, për afërsisht shpenzimet kapitale në të njëjtin nivel, vitin e kaluar ju jeni arsyetuar vazhdimisht që ngritja e çmimeve ka ndikuar që disa kontrata s'po ekzekutohen dhe s'po implementohen. A ka qenë arsyetimi i duhur atëherë, ose pse tash e kemi pothuajse shpenzimin e njëjtë të shpenzimeve kapitale. Nëse e analizon kështu në përgjithësi buxhetin, unë kisha thënë që kjo është një qeverisje jo energjike ose qeverisje dembele.

Latif Ramadani, tha se raporti bahet për me informuar qytetarët për shpenzimin që ka ndodhë, është shpenzim real nuk mundem me ndryshua, as me u rritë, as me u zvogëluar, kanë ndodhë këto shpenzime, jemi në këtë periudhë që kaq

ka arritë ,deri më 30 tetor që ka pas shpenzimeve dhe këtë muajin tetor, mirëpo këto pasqyrohen në raportin tjetër 3 mujorsh, 3 mujor shin e katër dhe unë besoj që me dinamikën e punëve që është tu e bërë, ka me u ngritë dukshëm përqindja e shpenzimeve. Secila kategori e prek qytetarin, edhe mallrat dhe shërbimet, edhe subvencionet, edhe komunalitë, edhe të gjitha kategoritë janë të rëndësishme, mirëpo periudha ndryshon se te kapitalet i kanë disa procedura tjera, që normalisht nuk mund me zhvillu procedura deri në maj, e përmendi Kryetari, merret edhe OSHP-në, që jashtëzakonisht shumë na pengon në mosrealizimin e disa projekteve që kanë me ndikuar edhe në shpenzime, mirëpo unë besoj që me dinamikën që është duke ecur, unë besoj që një përqindje jashtëzakonisht të madhe ka me ka me shpenzuar buxhetin edhe në kapitale, mirëpo na siç e dini, para nja dy-tri seancave e kemi bërë edhe ridestinimin që është një shumë e konsiderueshme që e kemi aprovuar edhe e kemi dërguar në Ministri, mirëpo nuk ka kaluar. Edhe nëse nuk kalon edhe sot edhe nesër, normalisht që ato krejt mujne me shkuar suficit, mirëpo na e kemi bo një përpjekje që është e nivelit lokal, e pengesat që vijnë nga niveli qendror, normalisht që na nuk mujna me m'i shty me zor se ato janë procedura që duhet me respektuar.

Besiana Sylja, tha se dhe po mos me i dhënë vërejtje kurrë nuk bën, atëherë bëne që raport i miratum, jo alokum qysh e ke prur. Kur ta qitsh kur ta lexoni që është buxhet i miratur, atëherë unë nuk dhë vërejtje, por derisa e vjen qatu gjënë jonë, kam me të kam me t'i dhënë vërejtje gjithë.

Latif Ramadani, tha se buxheti i alokuar dhe miratuar dallon kur te doni ne zyre hajdeni ua shpjegoj?

Fitim Mëziu, tha se pata një pyetje ndoshta është më tepër në aspektin teknik, por disa herë e kemi diskutuar këtu ndërtimi i një qendrës urgjente, keni bërë që sa herë po përsëritet po e njëjta. A kemi të drejtë në aspektin legjislativ Komuna e Lipjanit të ketë qendër urgjente, domethënë ato i takojnë komunave të cilat kanë mbi njëqind e tridhjetë mijë banorë dhe këtë gabim teknik duhet me ndryshuar dhe sa i përket një aparati të Rengenit dixhital, me sa e di unë ai domethënë është një aparat që është ble ose është marrë nga qendra e punës Obiliq kurse këtu po figuron që është blenë një aparat digjital ë ndoshta s'kena informacione të plota. Nëse keni mundësi me na informur për këtë.

Lulzim Rrustemi, tha se te ndërtimi i qendrës së re të kulturës një shpronësim për cilën qendër të re të kulturës është fjala një shpronësim te madh.

Latif Ramdani, tha është shpronësimi që ka ndodhë obligimi që nuk ka marrë përmbaruesi, normalisht që i merr cilindo kod na vetë neve ku me i marrë kur të kryhen procedura. I ka marrë prej kodit qendra e re, jo që është shpronësu qendra e re. Qendra që e përmendi qendra urgjente, që është ndoshta një përshkrim që na në raport nuk mujna me ndryshuar përveç një së procedurave qysh u planifikun a është mirë a keq.

Pastaj u kalua ne piken ne vijim.

III

Propozim Vendim për miratimin e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Lipjanit 2023-2027.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rustemit, nga DSHPMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se para se me e hap diskutimin, janë në dy gabime teknike, nuk e di a drejtori i përmendi a jo. Njëra është te neni një dhe neni dy, domethënë duhet me qenë në 2027 jo 2025

Jashari, tha se fillimisht, material shumë voluminoz, ndoshta dikush edhe se ka lexuar veç, po është pak e çuditshme kur flasim për një plan strategjik për mbeturinat e që Komuna e Lipjanit, e kjo shoqëri, është duke pasur problem me mbeturina, paramendoni në dëgjim publik është prezent veç Arsim Jashari edhe zyrtaret që kanë pasur me elaboruar planin. Sa i përket këtij planit, unë e besoj e ka një problem shumë të madh ky plan, nëse nuk e keni pa, nuk mundet me ardhë plani për menaxhimin e mbeturinave, kur nuk ka lokacion për tri deponitë kryesore që janë. deponitë e materialeve ndërtimore të demolimit dhe ato të inerte. Këtu s'ka në këtë plan sepse nuk ka lokacion për mbeturina Nëse brenda këtij plani, nuk është kjo me kundërshtuar politikisht, brenda këtij plani unë nuk po shoh që ka me Deponi, a besoj që po pajtojnë të gjithë. Nëse nuk e kemi brena, e kam lexuar krejt, edhe pse një pjesë nuk ka të bëjë me mbeturinë, apo ka të bëjë me procesin qysh vazhdon siç është ai Problemi ynë është me gjetë një vend, ky plan që tash me i pas me ana në strategji të mirëfilltë për vjetësimin e qytetarëve, s'po flas për ata qytetarë që janë pa ndërgjegje Nëse s'ka infrastrukturë ka drejtë me ligj, jeni lexoni ligjin që është për mbeturinë, ka

drejtë me polici. Ju kisha propozuar që me menduar që ky plan për mendimin tim nuk i plotëson kërkesat dhe problemet që i ka Komuna e Lipjanit dhe qytetarët e Komunës së Lipjanit.

Rinor Murati, tha se sa i përket këtij propozim-vendimi për miratimin e planit për menaxhimin e mbeturinave, konsideroj se ky plan përmban objektiva konkrete, siç janë: stimulimi i bizneseve me pako zero, ambalazhim, rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për çështjet e minimizimit dhe reduktimit të gjenerimit të mbeturinave nëpërmjet fushatave vetëdijësuese, shtimi i numrit të kontejnerëve është një nevojë të cilën drejtoria përgjegjëse duhet të angazhohet që ta realizojë, në mënyrë që t'i mënjanojmë deponitë që po krijohen.

Ganimete Qeriqi, tha se unë çdo ditë kaloj nga rruga ku menaxhohet tregu aktualisht, aty tmerrësisht ku tërbon fakale, ka shtazë e insekte të ngordhura. Ato baraka janë prej kur ka filluar jeta në Lipjan, të mbushura tani me mbeturina të ngordhura 6 ditë kur nuk është treg. Ajo vend frekuentohet me 10 qen endacak dhe mbushet. D.m.th është një ambient total i pa pastër edhe për tregtarët dhe konsumatorët, Deri në zhvendosje të tregut duhet të krijohen kushteve, ambiente të pastër me u mbajtur tregu të ketë rrethoj, ku vendoset prodhimet e qumështit, peme perime e të tjera, Të menaxhimi i mbeturinave ,mbase përfshihen shume. Unë kam edhe një dukuri negative, që po ndodhë në vendin ton, kur veturat po i aksidentojnë qentë endacake, ata po mbesin në rrugë , ashtu mbesin ,veturat tjera që mbi ta deri sa ta shtypin ters ishte , kjo nuk bën me ndodh ,kompanitë e pastrimit duhet me bashkëpunuar me operator të tjerë, këto mbetje duhet me u larguar nga rruga sepse krijohet edhe një imazh i keq për ne. Edhe në oborrin e shkollës Ismail Luma , kish qen të ngordhur dhe era e rend po i pengojë nxënësit.

Fitim Mëziu, tha se ky projekt për propozim, pra plani i menaxhimit të mbeturinave vërtetë është një vendim i qëlluar, është jashtëzakonshëm i rëndësishëm për një ambient të pastër në Komunën e Lipjanit. Por nganjëherë edhe ato grupet punuese, të cilat hartojnë këto plane, dinë të fusin të dhëna, të cilat jo rrallë janë të pasakta dhe na duhet me pas kujdes kur bahet një plan i tillë, të jetë vërtetën për në përputhshmëri me realitetin në të cilin jetojmë. Për shembull, menaxhimi i mbetjeve në aspektin shëndetësor ku bëhet, është një metodologji tjetër që bëhet, për arsye se ato kanë mbetje të gjelbërore në mjete tjera shëndetësore, të cilat duhet të ketë kujdes se ku mund të hodhën ato dhe e ka një faktikisht Ministria e Shëndetësisë është një prej atyre të cilat çdoherë ose inspektorati ku ne duhet me dhënë një përgjegjësi. Është një gabim teknik e kam fjalën, shkruan ato që janë shtatë AMF, na e dimë që AMF-në Bnauullë dhe është inekzistente, po ashtu edhe AMF në Smallushë nuk

funksionon, asnjëherë s'ka funksionuar Disa AMF funksionojnë dy-tri ditë. Parimisht, domethënë, të kemi kujdes se çfarë dokumenti të aprovojmë, por iniciativa është jashtëzakonisht e mirë.

Bashkim Budakova, tha se përket rëndësisë së këtij propozim-vendimi është i rëndësisë së veçantë për të gjithë qytetarët, mirëpo u tha prej kolegëve rëndësia e kësaj përmbajtjeje, mirëpo deshta me ndal diçka të është teksti ka problem me përmbajtjen, meqë është dokument zyrtar, domethënë është gabim teknik, mirëpo është domethënë s'ka shumë gabime teknike në këtë përmbajtje të tekstit. Këto gabime teknike i kam pasë paraqitë edhe një herë më herë në seancat më përpara, mirëpo nuk është marrë për bazë. Po lexoj disa prej tyre që janë të ardhmen, unë besoj që të korrigjohen dhe të përmirësohen. Për shembull, te pika dy pikë një te pozita gjeografike, Komuna e Lipjanit ka pozitë të përshtatshme gjeografike, sepse gjendet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës, në kyçe të rrugëve të rëndësishme të rajonit kufizohet me komunat. Domethënë, kufizohet dy herë me komunën e Ferizajt e kemi, përpos komunave tjera që kufizohet dy herë e kemi, është gabim teknik, mirëpo është gabim... po. Te pika dy pikë dhjetë Administrata Publike. Sipas statutit të komunës së Lipjanit, organet e komunës janë kuvendi i komunës, është organi më i lartë i komunës dhe kryetari i komunës është organi ekzekutivi i komunës. Kuvendi i komunës udhëhiqet nga kryesuesi i kuvendit, kuvendi përmban tridhjetë e një anëtarë, kurse organi ekzekutiv udhëhiqet nga kryetari i komunës, ka dy nënkryetarë dhe dymbëdhjetë drejtorate, nuk janë dymbëdhjetë drejtorate, por janë trembëdhjetë. Unë e kuptoj ndoshta që u bë kopi pas, mirëpo duhet të korrigjohet nëna. Te pika katër pikë gjashtë, objektivi numër katër: Deponimi i sigurt i mbeturinave si mjet i sigurt. Kjo objektivi referohet gjendjes aktuale në terren, për çdo vit evidentohet një numër i caktuar i vend-hudhjeve ilegale të mbeturinave, me qëllim të sanimit të gjendjes Komuna e Podujevës do të angazhohet, Komuna e Podujevës do të angazhohet, s'po e kuptoj, Komuna e Podujevës do të më angazhur për me për çdo vit të organizojë pastrimin e këtyre lokacioneve, të ndotura mbeturinat dhe vendosjen e shenjave informuese dhe ndërgjegjësuere e njoftuese për mos-hudhjen e mbeturinave. Nuk e kuptova Komuna e Podujevës, te pika katër pikë gjashtë, objektivi numër katër. Edhe meqë është dokument zyrtar, mendoj se duhet të përmirësohet kjo përmbajtje.

Egzona Bytyqi, tha se para vetit e kemi një dokument strategjik të një rëndësie të veçantë. Përveç asaj analize që shefi jonë i grupit në mënyrë detaje e prezantoi para jush, domethënë neve na mbetet pak me diskutuar, mirëpo përfshirë edhe para folësit e tjerë, Ne si institucione ndër të tjerash e kemi obligim që disa shprehi të mira sociale të provojnë t'i instalojmë qysh mosha të reja. Domethënë, ideja jem është që të

mundohemi të gjejmë modalitete nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme që ta rrisim vetëdijesimin duke filluar prej nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme për rëndësinë që e ka ruajtja e ambientit.

Lulzim Rrustemi, tha se këtu janë anashkaluar këto gabime teknike që nuk do të duhej të ishin në plan dhe duhet me u largu dhe duhet me pasë parasysh gjatë hartimit që plani të jetë i mirëfilltë dhe konciz, sepse ky është dokument zyrtar, i cili mbetet në arkiv dhe çdoherë mund të jetë target i njerëzve, të cilin mund ta lexojnë. Ne plane po bëjmë, po veprimin e kundërt të materializimit, asnjëherë s'po e bëjmë. Ju e dini, kemi dy vendime të Kuvendit Komunal të Lipjanit, edhe për deponitë e ngurta dhe tjetra për groposjen e shtazëve të ngordhura. Asnëra s'është materializuar ka tri-katër vite që jena provu asnjëra s'është ka mujt me hy në funksion. Ne jemi në hartim të planit zhvillimor urban, i cili mund të nxjerrë këndita tjera dhe në planin zhvillimor urban nuk ka të planifikume deponi, të cilët në vitin 2023 cka kemi me bo Çështja madhore është a do të ketë në Lipjan deponi regjionale, për çka diskutohet gjithë ka e çdoherë e na kena pyet edhe këtu. Na mendojmë që ky plan do të duhej me u hudhë fillimisht si plan i aprovim, me pritë planin zhvillimor komunal që është në zbatim, e pastaj me startu me me konceptin.

Burim Rrustemi, tha se gabimet teknike përmirësohen por ideja e këtij plani që është hartuar dhe është financuar direkt pjesa e ekspertizës rreth tij përpunimit të këtij plani, jo vetëm për Lipjanin, vazhdimisht për krejt komunat Kosovës, diku në tridhjetë e tetë komunat që janë funksionale e kanë një plan të tillë, të cilin duhet përherë ta qesim për aprovim, me arsyetimin, po flas që mos me i humb donacionet si shtet, po flas si institucion, gjithmonë të marrim për bazë institucionet e nivelit qendror, ministritë që janë, duke marrë për bazë planet e tona komunale që kërkohet prej neve me i pasë, me jo patë ato edhe dhëna, dhënat shumëta që janë mrena për mrena territorit tonë të Lipjanit që ka nevojë për me ndryshu, ka nevojë për të ndryshu edhe gabimet teknike, po duke marrë për bazë, duke marrë për bazë, nëse kemi një plan Ne e kemi me ja plotësu një shtyllë për hapjen tutje me vazhdu ministritë për fonde që ata aprovojnë në organizatat e huaja ose shtetet e huaja, si është GIZ-i Gjerman edhe të tjera.

Arsim Jashari, tha se për me përpunuar një plan, dhe strategji, duhet kohë, është afati ligjor e keni pasë kohë. Nuk mundem me e pranuar një plan të gabueshëm, edhe si në aspektin teknik, si në mundësimin strategjik, problemin të cilat haset komuna liruan, veçse me i fituar grandin qeveria ose me fituar edhe na nëpërmjet qeveri. Plani ka gabime teknike, në plan nuk ka strategji adekuate, decidive si me eliminuar dukuritë negative me deponi legale.

Burim Rrustemi, tha se sa i përket gabimeve teknike, mundemi me i përmirësuar, planit janë përfshirë shumë gjana, po flas reale, që mund me kanë sa i përket statistikave të dhënave, deponimeve ma hershme. Po se pjesa e objekteve ose produkteve të vëllimshme një, edhe inerte, është një problem, nuk është veç një plan. A trajtohen në mënyrën më të mirë, po flas me Deponitë që janë, që ekzistojnë në vendet e zhvillume, na nuk mund, jo në asnjë komunë, por edhe shteti, si shtet nuk ka më mujt me funksionuar. Duhet me u bërë dikun, për shkak që me u kthyer këto mbeturina me u kthyer tre përsëritshme që sjellin edhe të hyra, se është një kosto shumë e madhe e menaxhimit që nuk ka mundësi me kry një komunë e vetme çfarëdo qoftë edhe krye qytetin.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se Plani që është, është bërë sigurisht që nuk duhet të shkojë me gabimet që ju potencuat dhe që u diskutuan prej gjithë juve, një send po dua me cek që bashkë me drejtorin kemi pasur një takim me përfaqësues të Gizit Gjerman, edhe kryetari që disa herë ka pasur takime edhe me ambasadorin gjerman edhe me aq shumë kanë insistua që në Lipjan me qenë deponia regjionale për Komunën e Prishtinës dhe komunat që janë përreth, por ju siguroj një gjë që sa të jemi na në pushtet, nuk do të lejojmë një deponia regjionale në komunën tonë.

Arsim Jashari, tha se, konkret plani është i paraparë vetëm për mbeturinat që bëhen në pagesë, qytetarët që i paguajnë, nëntëdhjetë për qind e planit, tri planit, se kam lexuar me mendje, i parasheh mbeturinat që paguhen prej kompanisë regjionale. Nuk unë po të flas tjetër send, po flas për një për një iniciativë që e kam në temën personale. Por, nëse nuk e kemi brenda këtij plani, ne kena me pasë problem me i trajtuar.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ky është një plan mas dy-tre muajve e një viti nuk është të thënë, ishalla do të zoti fillojnë na me implementuar ose na ndihmojnë edhe të tjerët, organizatat e tjera, sepse vetë e thara drejtore është e pamundur me i trajtuar këtë këtë çështje, por është diçka që është si të bëhet, nuk ndryshohet, thjesht është një hap që është bërë dhe po mendoj që mundemi me ndryshuar apo plotësuar, gabimet teknike do t'i përmirësojnë. Unë nuk do ta nënshkruaj planin pa e korrigjua gjuhësisht edhe teknikisht, mandej nëse votohet, kuptohet.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se këto u dhanë shumë vërejtje sa teknike, aq edhe përmbajtjesorë dhe unë po e shoh nevojën që ky plan me u shty për një mbledhje, për mos me marrë votën kundër. Dhe te jetë një plan i detajuar dhe te shtohen edhe kaptina për rastet emergjente

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se, gabimet teknike do t'i përmirësojnë, unë nuk do ta nënshkruaj planin pa e korrigjuar gjuhësisht edhe teknikisht, mandej nëse votohet.

Shahadije Bikliqi, tha se në bazë të diskutimeve që u bënë me të vërtetë këto gabime teknike, për mua janë skandaloze, por më skandaloze është deklarimi i drejtorit kur vetëm thellohet në skandal, duke thënë se e bëmë në plan, me pëlqimin tonë, kjo po bjen që shumë punë, i bëni veç për tokë edhe përfitime.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ndoshta u keqkuptuat pak, unë nuk desha mu lëshuar në detaje ajo që e tha Arsimi, s'kena qenë pjesë në diskutimin publik kur u bo nuk po dua me i fajësua se s'kam qenë as unë atë ditë. Edhe është gabim edhe për mua, sepse është një çështje që njna prekë gjithëve, secili lokalitet, secili vend dhe nuk kemi gjetë kohë me ardhë atë ditë, të paktën me dhënë kontributin. Mbetet ju me vendosë a doni me votuar ose jo. Gabimet teknike dhe gjuhësor çka janë, ato do të përmirësohen, do ta dërgojmë përsëri unë personalisht, te lektori, për shkak që nuk do ta nënshkruajë pa u përmirësua.

Burim Rustemi, tha se nuk është për skandaloz, se mund edhe mos me votuar hiç. E penalizojmë si institucione, e nivelit qendror, për donacione të ndryshme që janë dashtë me punuar këtë këtë drejtim trajtim të veçantë kemi vetëm ekonomitë familjare, çka bëjnë mbeturina. Na vetëm pjesën teknikisht që duhet me u rregulluar.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se unë, unë nuk e përmenda si skandaloz këtë raport, po me te vrertën ky është një dokument me gabime teknike gjuhësore skandaloze.

Alban Salihu, tha se unë nuk deshta me u përfshi, por më intrigoi kjo tendenca e drejtorit për me kthye në rrafshin moral çështjen, duke na kërkuar me votuar se ç'është mirë për qytetarët, na e vlerësojnë qysh votojnë edhe ju i keni votat kaloni, po nga çka u diskutu këtu, po shihet që përpilimi i këtij dokumenti ka probleme.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se unë e thashë, të gjitha gabimet që u por të gjitha gabimet që janë teknike, qoftë gjuhësorë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për, 11 kundër, 1 abstenim aprovoi propozimin

Pastaj kryesuesi dha pauze nga ora 12:00 deri ne ora 14:00

Pas pauzës u vazhdua pjesa e dytë e mbeldhjes.

IV

Propozim Vendim për Fillimin e proceduarave për shpalljen e konkursit publik për vendosje të bizneseve në zonën ekonomike “Parku Industrial” në ZK Qylagë – faza e dytë.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit nga DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se ne i kemi pasur rast si pjesëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa në detaje me bashkëbisedua, kështu në përgjithësi, kur është bërë fjalë domethënë për këtë plan të biznesit, si Parti Demokratike e kemi trajtuar me seriozitetin dhe me rëndësinë më të madhe, është një plan që ka të bëjë me zhvillimin ekonomik, jo vetëm të Lipjanin, mirëpo e konsiderojmë si edhe ma gjerë, mirëpo të jemi realiste, dinamika e punës që ka qenë deri më tani aty ka vende kanë për hapësirë dhe për pyetje-diskutime mirë, por në komision t'u referova me po të njëjtën qasje, domethënë edhe këto vonesa kanë bërë me sa kuptova me çështje administrative, me çështje burokrat burokratike. Në këto rrethana, unë besoj dhe shpresoj shumë që ky park ka me qenë për me tërheqë biznese, ajo çka kisha të propozohem që si komunë m'i kushtuar shumë vëmendje promovimit dhe marketingut të kësaj zone. Ne Parti Demokratike, e përkrahim.

Fadil Spahiu, tha se e mbështes këtë propozim-vendim dhe uroj të ketë interesim të investitorëve, në mënyrë që të rritet mundësia e punësimit të qytetarëve të komunës sonë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, 4 abstenim aprovoi propozimin

V

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike “Parku Industrial” në ZK Qylagë – faza e dytë.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Gentiana Hoxha tha se ne si Grup Parlamentar i LDK-së e propozojmë për anëtar të komisionit ,Fitim Shala.

Egzona Bytyçi tha se ne si grup i PDK-së e propozojmë për anëtarë të komisionit Lulzim Rustemin.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 5 abstenime, aprovoi propozimin

VIII

Propozim Vendim për faljen e borxheve të pa paguara për taksën për marrjen dhe mbajtjen e lejes për ushtrimin e veprimtarive afariste.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacolli,drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se fillimisht, unë po mendoj që ky vendim është i mangë nga përmbajtja dhe nga informatat që na duhen njerëzit si anëtarë të Kuvendit për me votuar. E para, Rregullorja e ka ndërprerë, por Rregullore nuk ka thënë që mos mu kërkuar borxhin, por në ndërsa pse nuk është kërkuar borxhi me u paguar. E dyta, neve na duhet mrena vendimit me i pasë emrat e subjekteve afariste, kur ne jemi ato ia fol borxhin, kush janë ato subjekte afariste të cilat Kanë bërë që si dy me kanë emrat, me emrat ose emrat e firmave ose të personave juridikë ose personave fizikë nisen kanë qenë E treta, po flasim për një shumë diku pesë mijë pesë qind mijë euro, ashtu nëse s'gabo, pesë qind mijë e shtatëdhjetë e shtatë mijë euro, është mirë me pasë ne emrat. Ky vendim është i mangë, si nga informatat e si nga përmbajtja e vendimit.

Shahadije Dragaqina, tha se pajtohem me parafolësi, që e përmendi mungesën e listës të borxhlinjve, por unë e kam një pyetje: Pse nuk është falë ky borxh më herë, por është dashtë me prit dhjetë vite për me ardhë ne kuvend.

Fadil Spahiu, tha se e mbështes këtë propozim-vendim për foljen e borxheve të papaguara për taksën për marrjen dhe bartjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afaristeve për të gjithë subjektet afaristë, meqë është shfuqizuar Rregullorja, me anë të së cilës kanë qenë të përcaktuar taksat për marrjen dhe bartjen e lejes së punës, si dhe ka kaluar kohë e gjatë dhe borxhet janë vjetërsuar.

Valon Pacolli, tha se çështja pse s'është e adresuar nëpërmjet këtij propozim-vendimi, emri dhe mbiemri i subjekteve, mendoj që është çështje konfidencialiteti, mirëpo këtë dhëna t'i kemi na në Departamentin tonë i ka edhe sektori edhe zyra ligjore, për këto dhëna muni me marrë informacion direkt me në departament tonin. Ne kemi konsideru që nëpërmjet ë vendimit të Kuvendit Komunal me adresuar këtë çështje në Ministrinë të Financave, në mënyrë që me bere kërkesë për shlyerje këtyre borxheve.

Arsim Jashari, tha se Rregullorja e vitit 2014,e keni nxjerrë për me ndërprerë qatë farë taksi mos me pagua mua, por nuk është nxjerrë për me falë borxhin. Borxhi ka qenë evident, a është ashtu.Nuk mund me qenë diçka konfidenciale kur na jemi tu u votuar për me ia falë borxhin, se na po votojnë për me ia falë borxhin. Po na jemi tu e marrë një vendim domethënë, na po falë me një obligim që ka qenë obligim ndaj Komunës dhe është dëmtuar komuna, se nëse ka qenë ai taksë dy mijë e katër dy mijë e trembëdhjetë, ajo ka pasë njëfarë qëllimi. Kish qenë mirë me qenë lista e subjekteve afariste, me ditë ku na pi falët borxhi.

Latif Ramadani, tha se veç një sqarim, sigurisht Valoni e tha po Nuk fjala për falje të borxhit, por është për shlyerje të borxhit që mos me pasqyruar në pasqyra financiare. Procedurat për me marrë si borxh, normalisht që i kanë ndjekë drejtoratet përmes Zyrës Pronësore që i kanë çu njoftimet vërejtjet, mirëpo edhe kështu i ka më shumë se dhjetë vjet që është i parashkruar edhe një pjesë e komunave që kanë fillu me ba qëta që mos me pasqyrua çdo vit në pasqyra financiare që kjo ka qenë.

Arsim Jashari, tha se Vendimi shkruan falje, jo shlyerje ,falja e shlyerja, në aspekt juridik ka dallim të madh,për parashkrimin e një lëndës, kupto nëse është temë pesë vjet, duhet me i puno një e dyta dhjetë vjetëve pa të shkruhet lënda. Nëse parashkruhet ajo në aspekt juridik, nuk bën dëm automatikisht bien, por nëse shkruajmë vendim faljen, ne jemi tu falë se diçka, ne kena me votua për me falë, jo për me fshire.

Valon Pacolli, tha se që na nuk e kemi marrë hap deri tash, përderisa po dojmë me marrë si hap, na e kemi qenë në kuvend komunal edhe me proceduar tutje me shlyerje të borxheve.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për, 11 absteime, 1 kundër, aprovoi propozimin

VI

Propozim Vendim mbi caktimin e tarifave për qëndrim ditor të fëmijëve në institucionet parashkollore në fshatrat e Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasnait drejtor i DKA i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albiona Tasholli, tha se ne si Grup Parlamentar i LDK-së ke kemi edhe një propozim për me ndryshuar domethënë një pjesë të propozim-vendimit. Propozimi është që çdo i treti fëmijë një familje të lirohet nga obligimi për pagesë ndaj çerdhes. Ky propozim synon ta lehtësojë barrën financiare të familjeve me trau se më shumë fëmijë dhe të ndikojë në stimulimin të nacionalitetit të familjeve Kosovare. Ne si grup parlamentar i LDK-së kërkojmë edhe nga anëtarët e tjerë të Kuvendit ta mbështesin këtë propozim-vendim.

Herolind Kozhani, tha se në emër grupit të PDK-së dhe propozojmë të vazhdohet deri në mars të vitit dy mijë e njëzet e katër. Lirimi nga pagesa dhe nga marsi të shtohet me pagesë. Për dy arsye, e para jemi në fund të vitit dhe është një lehtësim shtesë dhe stimulim për t'i ndalë fëmijët nëpër lokalitete ku jetojnë. Dhe e dytë është janari kur pritet të ketë një ekzod të madh të qytetarëve drejt vendeve të BE-së. Andej, me propozim që ky vendim paraprak të jetë në fuqi dhe ky vendim i tanishëm të mos votohet deri në mars të vitit një mijë e njëzet e katër.

Fadil Spahiu, tha se e mbështes këtë propozim-vendim, në të cilin përcaktohen obligimet e prindërve, përkatësisht kujdestarëve për pagesën e tarifave për qëndrim ditor të familjeve në institucionin parashkollor në fshatrat e komunës së Lipjanit. Tarifa në shumën prej tridhjetë eurove për fëmijën e parë dhe tarifa e zvogëluar për më shumë se një fëmijë për çdo muaj në emër të participimit në bazë të standardit

komunal të jetesës mendoj se është e arsyeshme dhe vërtet kontribuon në përkrahjen dhe nxitjen e punësimit të nënave në fshatrat e Komunës së Lipjanit.

Arsim Jashari, tha se Unë e mbështes në tërësi propozimin e Herolindit, po dua me shtuar diçka, propozimit shtesë në vendime ose duhet me u prezantua në Komitetin për Politike Financa ose duhet me u kthyer vendimi me plotësim të dy neneve dhe me u kthyer nuk jemi kundër propozimit, po jo këtu tash, po besoj që ata që janë Profesionit e dimë domethënien .Nuk mund të na mbështet propozime shtesë kur nuk është në vendim, se ne për moment e kemi këtë vendim. Përse është Komiteti Politik e Financa dy dhe të ri përpara mbledhjes, që këto dy propozime janë shumë të mira si propozime, por duhet me u dhënë në Komitet Politik e Financa për të marrim me votuar komplet vendimi, se ky po e votojmë me plotësim-ndryshim.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se kuvendi e ka të drejtën e propozua tash edhe pro propozimi atij edhe i cilitdo, në rast se juridikisht nuk preket ose nuk ka diçka që mundet me pengu ose financiarisht, mujna me bë si propozim edhe me fut. Nëse jo, na patjetër që duhet me bë më herët ose me shty përmbledhjen e ardhshme. Po propozimet mund me ardh prej secilit anëtar të Kuvendit. Ki drejtë ki drejtë që Komiteti për Politicë dhe Financa, në rast se bëhet ndonjë propozim, sigurisht që na jep hapësirë ma shumë me menduar edhe me diskutuar edhe me mendua a është i drejtë apo cilat janë pasojat e atij propozimi.

Arsim Jashari, tha se propozimi i Herolinit nuk është për me shtuar nene ose me shtuar diçka në vendim, është propozim me vendim me u lirua prej pagesës, me i shty deri në mars. Ndërsa dy propozimet edhe i drejtorit edhe propozimi i koleges Albionës është për me u fut në vendim.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ky vendim vlen edhe për çerdhen e Gadimes e Sllovis, po vetëm për çerdhet e reja që po hapen, sepse ato janë tu pagunë në Gadime e Sllovië,

Rasim Hasani, tha se veç sa për me e sqarua edhe propozimi i Herëlini duhet me shkruar dikund, përndryshe tash një propozim për shtesë, besoj që Kuvendi e ka për monitorim Kisha kërkua që me hije, me domethënë me u votua fëmija i tretë qysh ke propozimi pa pagesë, të kuptohemi çdo fëmijë i tretë dëshmohet me certifikatë familjare, çdo fëmijë i tretë sistemi shkon çerdhe nëpër fshatar me kanë pa pagesë. Edhe të aplikimit të tarifave, më shtuar fjalinë, domethënë mbetet fjalia qysh është vetëm me shtuar fjalinë të institucionit parashkollor e të reja, vendimi të reja, domethënë që lëshohen për orën, vendimi për aplikim të tarifave të jetë pas fazës

testuese gjashtëmujorë, domethënë kjo me vlen për gjithë, për secilën çerdhe që ka me u bërë.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se edhe një sqarim, shtesë, se nuk po jena për me largu propozimin, se është i njëjtë, por nëse e lejmë deri në mars, e shënojmë, qysh e tha propozimi i Herolinit, çerdhja e Rucit është përfundim në qershor. Nëse e përcaktona një muaj, çfarë muajin prill ose mars, mandej një çerdhe tjetër mu me hapë në një periudhë tjetër që mundet me kanë më i shkurtë, ajo fazë ose më e gjatë.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit me po procedojmë, me ndryshimet ose riformulimet e neni katër, që do të jetë për fëmijët e tretë në familje të jetë pa pagesë edhe te aplikimi i tarifave neni pesë, domethënë të shtohet përveç çerdheve të reja domethënë, është neni pesë.

Pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për 6 kundër, 5 abstenim aprovoi propozimin

VII

Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës për përzgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit, drejtor i DKA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se si zakonisht unë në këtë pikë e propozoj me formalizuar kryetarin e komunës në kontekst të këtij komisioni, për shkak se unë besoj dhe është e ditur që as mbajtësit nëpër shkolla nuk pranian pa përfshirjen e tij, e lëre më drejtorë të shkollave, i kemi pa qysh shumica drejtorëve të shkollave, janë sh ndërrues në zëvendës të komunës, dhe jo si drejtorë shkollave. Pra, unë mendoj që duhet me formalizu kjo proces, dhe me kanë në listën e kryetarit të komunës.

Rasim Hasani, tha se ligji e ka përcaktuar që drejtori i një shkollës e zgjedh kryetari i komunës. Unë s'ju kam faj që kryetari i komunës është Imri Ahmeti.

Herolind Guzhani, tha se ne si grup i asamblesë së PDK-së e përkrahemi këtë propozim.

Arsim Jashari, tha se pajtona në atë çfarë e tha drejtori, që ligji e ka përcaktuar dhe vullneti i qytetarëve është i padiskutueshëm, por veprimi e qytetarëve pra të shihja përcaktuar ligji nuk e përcakton për me politizuar institucionet, por duhet me de politizuar institucionet, njëmend qëtu, besoj që pak është problem, se na jemi të Komunës së Lipjanit e dimë kush janë drejtorët.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për 3 abstenime, aprovoi propozimin

IX

Propozim Vendim për anulimin e Vendimit 15Nr.463-4331 i datës 19.01.2021 për pezullimin e Vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varreza në fshatin Rubovc 15Nr.463-14826 i datës 04.03.2019.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica-Llugiqi drejtor i DKRS, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Bashkim Budakova, tha se pika e rendit të ditës në diskutim: Vendim për anulimin e vendimit për pezullimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan, për varrezat e fshatit Rubovc, kërkesë e banorëve të fshatit Rubovc, të cilët kërkesë e kanë ngritur disa herë në Kuvend, vendimi është marrë për dhënien shfrytëzim të pronës komunale për varrezat e fshatit Rubovc, mandej pezullimi i këtij vendimi. Pas kalimit të këtij vendimi në procedurat gjyqësore, pra për dhënien shfrytëzim për varrezat e pronës komunale në vendin i quajtur Drum, me kulturë ar, klasa e tretë, me sipërfaqe prej tre mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë metra katrorë, zona kadastrale e Rubovc. Banorët e fshatit të Rubovc, kërkoj nga gjithë kolegët propozimin dhe votimin e këtij propozimi.

Arsim Jashari, tha se ne si grup ne si grup i asamblesë së PDK-së e mbështesim këtë propozim, unë e kam pas bërë një kërkesë për një Rregullore tre. E kemi pas bërë një propozim që të jenë një nen në rregullore ku me qenë për varreza, domethënë e jo me varros në njerëzit ku do që mujnë por duhet të jetë një rregullore që cakton se ku duhet të varrosen të vdekurit, siç është disa fshatra, ku i varrosin kudo që mujnë.

Daut Azemi kryesues i kuvendit tha se e di që ka pas dhënë urdhër kryetari me shikuar , po mos është filluar tani komplet Rregullore e re, nuk e di, po do të interesohem për këtë çështje.

Shahadije Drgaçina, tha se unë në vitin 2019, kur ish dhanë ky vendim për këtë pronë, nuk jam kanë, veç tash që po më shqetëson fakti qysh komuna e jep në shfrytëzim një tokë e dikujt tjetër kur është veç me këtë rast, po për shumë raste po vijmë vendime, për anulim, jo për pezullim, për shkak se komuna, që tregohet jashtëzakonisht jo serioze, për shkak se nuk bëhet asnjë analizë, as nën verifikojnë vendimet, as nuk bëhet naj-fezibilitet për çfarëdo vendimi që neve na ka ardhë dhe na kjo është shqetësuese. Qysh ka mundësi komuna me ia dhanë një pronë pa bërë verifikim.

Daut Azemi kryesues i kuvendit tha po mundohna me të dhënë një përgjigje para se me vazhduar me diskutantët e tjerë, prona ka qenë pronë e komunës dhe ka figuruar pronë e komunës dhe varrezat aktuale që janë, domethënë janë varrezat aktuale në atë pronë. Pretenduesi i pronës ka kërkuar që nuk ju ka kompensua me disa dokumente që i ka gjetë të vjetra, meqë ato dokumente kanë shkuar tani në gjykatë edhe ka vazhduar procedurën e tij, është e kohës shumë të lartë, po që gjykata ia ka njohur të drejtën në bazë të arsyetimit që ka dhënë ajo.

Shahadije Dragaçina, tha pasi që jemi tu diskutuar për varrezat kam një kërkesë, për varreza nga banorët e Gllgovcit, për shkak që me nuk kane hapësirë për varreza, kanë kërkuar që me i bë zgjidhje për ata, nuk e di a ka plan komuna me u siguruar aty në një pronë për varreza.

Rinor Murati, tha se sa i përket kësaj pike, është mirë që po përfundon si procedurë, një vendim mjaft i nevojshëm për fshatin Rubovc, kështu që në emër të asamblesë së LDK-së e mbështesim.

Nexhmedin Lekiqi, tha se na krejt një dëshmitar që po i shoh një numër të varrezave që janë pak më specifike janë banim, por fshatrat janë plot. Nëse na e themi se 500 metra prej lokaliteteve mos me ndërtuar varreza, çka nëse me ata varrezat e reja 500 metra larg, se dikush ka pronësi më afër, ndërton në shtëpi, ndërton bën banim. Unë mendoj që do të gjetë lokacionin më i përshtatshëm. jo metra, jo kriteri, se mendoj hartë në vështirësi me pronat private. E dyta, sa i përket këtyre varrezave të fshatit Rubovc, po më duket dalim serioz, a po më duket?

Daut Azemi kryesues i kuvendit tha se kur të vjen Rregullorja e diskutojmë, duhet me gjetë modalitetin ma të mirë të mundshëm edhe ndoshta pesëqind ndoshta me një formë me një formë tjetër është çështje kur të vjen Rregullorja në Kuvend, do të diskutojmë bashkë edhe në diskutimet publike edhe në Kuvend për

me gjetë ma të mirën të mundshme. Edhe ne gjithashtu ka të drejtë se tani duhet me fut përmes urbanizmit si kriter ose varësisht qysh

Arsim Jashari, tha se, unë pajtojna me doktorin, por qëllimi është me mujt me ja ndalu me varros gjithkund. Nëse ti i thua, nuk ke drejt 500 metra, ai ka me qenë obligua me varrose atje, unë pajtona me ty, por qëllimi është me gjetë një masë për me parandalua, se s'po ndalen.

Fadil Spahiu, tha se, meqë procedurat gjyqësore të lëndës kanë përfunduar dhe se është realizuar kompensimi në dobi të kreditorit, e mbështes këtë propozim-vendim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, 3 abstenime aprovoi propozimin

X

Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Komunitete.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se, mirë që na ka ardh në Kuvend zëvendësimi i anës, për shkak që ka disa mbledhje që ana ka munguar, për shkak që është shpërngul në Kroaci për me jetuar. E mora fjalën për me i dhënë disa fjalë shumë miradije për Anën e cila në mënyrë shembullore e ka përfaqësuar komunitetin kroat dhe uroj që pasardhësi i saj ta përfaqësojë komunitetin e saj që ka mjaft shumë kërkesa, ashtu qysh ana e ka përfaqësuar deri tash. Përndryshe, e përkrahu fuqishëm kompletimin e komuniteteve për komunitete.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, aprovoi propozimin

XI

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për OJQ "Zëri i Romëve, ashkalinjëve dhe Egjiptianëve".

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit, drejtor i DKA-se i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se e falënderoj ë drejtorin për elaboratin e dhe për prezantimin e këtij propozim-vendimi, në seancën e kaluar, domethënë e kam ngritë si problematikë dhe si shqetësim, pasi që klasa domethënë e Magurë e ka qenë për atë kohë e mbyllur. Duke pasur tejet shumë të rëndësishme, këtë klasë e cila i është dedikuar mësimi plotësues diku rreth gjashtë ditë nxënës të komuniteteve kanë përfituar meqenëse ne si shoqëri në përgjithësi, edhe në të kaluarën, mirëpo edhe tash, nuk është se kemi bërë dhe jemi duke bërë mjaftueshëm përgjegjësi për komunitetet, në si grup i PDK-së e përkrahim këtë propozim-vendim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi propozimin

XII

Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtares të Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në Zk. Konjuh.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacolli, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se unë po shfrytëzoj rastin me përshëndetë plotësimin e komisionit, por e kisha një pyetje për drejtorin. Cilës organizatë ose shoqëri civile i takon kandidata në fjalë, sepse në komisione, ta keni parasysh, do të duhej me kanë njerëz profesionistë, njerëz që kanë kredibilitet, sepse shqyrtojnë tema jashtëzakonisht të rëndësishme, prandaj është e arsyeshme që edhe njerëz që përfaqësojnë ta kenë kredibilitetin e shoqërisë civile apo ka është e rekrutuar.

Valon Pacolli, tha se informatat që i kam, i përket Hendikos-së, është anëtare e shoqërisë civile, domethënë në këtë rast ka pas dy aplikime, është rekrutuar kjo, për shkak që edhe në aplikimet e rasteve bënë njëfarë rrotacioni, por për shkak që edhe Komisioni me përfshirë pak edhe gjini femërore.

Arsim Jashari, tha se na qe jena në Komision ankese është problem kur e ki, dike ne komision kur nuk është i fushës dhe nuk ju kupton gjërat. Është në rregull dhe ju kuptoj që duhet me kanë prej shoqërisë civile duhet me marrë, por kur të vjen në komision, për shembull, mos harroni se ne kemi obligimin me nesh me shkuar në burg, me marrë një vendim në gabuar, duhet me qene e përgatitur.

Valon Pacolli, tha se pajtohem në Arsim, për shkak që bile këto dy vite të fundit, bashkërisht me Lulin na ka ra mos të provuar komisione, dhe na normalisht kur i bëjmë thirrjet për me rekrutuar këta anëtarë të shoqërisë civile, e bëjmë njëfarë kriterit që me kanë së paku i përgatitjes superiore, e qesim edhe në konkurs publik, mirëpo ata na i referohemi që tij kriterit, por nuk e kenë përcaktuar për shembull këta jo ose këta po.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 16:15.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi